



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 31.10.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës **27.10.2023**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **H&B Consulting SH.P.K**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Ndërtimi i QKMF ne Drenas**" me Nr. të Prok: **206-23-6378-5-1-2** nxjerr:

V E N D I M

1. **HEDHET POSHTË**, si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik **H&B Consulting SH.P.K** e dt. 27.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Ndërtimi i QKMF ne Drenas**" me Nr. të Prok: **206-23-6378-5-1-2** kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK të datës 24.10.2023.
2. Mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e AK të datës 24.10.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik **H&B Consulting SH.P.K** me date 27.10.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Ndërtimi i QKMF ne Drenas**" me Nr. të Prok: **206-23-6378-5-1-2**. Autoriteti Kontraktues, me datë 31.10.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas **2A Group SH.P.K**:

Neni 1 – Qëllimi

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 72 – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Neni 7

Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

1. Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik.

Nuk pajtohem me vendimin e komisionit sepse dokumentacioni i dorëzuar i plotëson kriteret sipas DT dhe për më tepër komisioni nuk ka argumentuar fare arsyen pse nuk i përmbush.

Konstatimi i komisionit:

Tenderi i juaj është administrativisht i papërgjegjshëm:

ARSYETIM

Oftera juaj është e pa përgjegjshme për arsyet se Dokumentacioni i ofruar për menaxherin e projektit Arkitekt Valon Elshani, nuk i plotëson kërkesat e kërkuara sipas NJK dhe DT.

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

2. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve.

Andaj duke pasur parasysh argumentet e mesiperme bazuar në LPP dhe rregulloren e prokurimit kërkojmë nga ju që të anuloni këtë vendim dhe lenda të kthehet në Rivlersim.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shpenzimet operative lidhur me përgatitjen e dokumenteve si dhe na demton në fitimin që mund të realizojmë me nënshkrimin e kontratës për këtë aktivitet, si dhe demtimin e imazhit të kompanisë.

Pergjigjia e Autoriteteit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore

Ne Njoftimin per Kontrate dhe ne Dosje te Tenderit, te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, eshte kerkuar:

Kërkesa 3.

3.1 Një - Menaxher i Projektit – Inxhinier i diplomuar i Arkitekturës ose Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë, me përvojë 10 vjeçare profesionale në menaxhimin e projekteve ndërtimore.

Dëshmia 3.

- Lista e stafit profesional e nënshkruar dhe vulosur - Certifikata për efijence të energjisë, për njërin nga inxhinierët e kërkuar.
- Diplomat e noterizuar (fakulteti sipas sistemit 5 vjeçar ose master),
- CV-t e nënshkruara nga vet inxhinieret,
- Kontratat e punës me punëdhënësin ose marrëveshjet mbi angazhimin për këtë projekt,
- Referencat për përvojën e punës sipas kërkesës, gjithashtu, për Menaxherin e projektit si dëshmi kërkohet - Vendim për caktimin e Menaxherit te projektit.


Dokumentacioni i ofruar për menaxherin e projektit Arkitekt Valon Elshani, nuk i plotëson kërkesat e kërkuara sipas NJK dhe DT, konkretisht te dëshmitë: **CV e nënshkruara nga arkitekti, Marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt.**

AK-MSh këtë e bazon ne faktin se i njëjti arkitekt është prezantuar si staf profesional edhe ne nje oferte tjetër për te njëjtin aktivitet dhe ku vërehet dallim i kuartë ne mes dokumenteve nga dy ofertat, për te njëjtin arkitekt, personi me te njëjtin numër personal.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**


Berat Marmullaku
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit